

# Zhvillimet e fundit në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për lirinë e shprehjes



**Liria e shprehjes dhe liria e medias**

<http://horizontal-facility-eu.coe.int>

<https://www.coe.int/en/web/freedom-expression>

Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës

#### **Buletini Nr. 4**

### **Zhvillimet më të fundit të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me Lirinë e Shprehjes**

Autor: Peter Noorlander.

Ky buletin u përgatit në kuadër të Programit të Përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019–2022", dhe projektit të tij mbi "Lirinë e Shprehjes dhe të Medias në Evropën Juglindore (JUFREX)".

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon "©Këshilli i Evropës, 2022". Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose e pjesëve të caktuara të tij, duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasbourg Cedex ose [publishing@coe.int](mailto:publishing@coe.int)).

Të gjitha korrespondencat e tjera në lidhje me këtë publikim duhet t'i drejtohen Divizionit për bashkëpunim për Lirinë e Shprehjes, Departamenti i Shoqërisë së Informacionit, DG1, Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimi i Ligjit, Këshilli i Evropës, Avenue de l'Europe F-67075 Strasbourg Cedex, France, Tel. +33 (0)3 88 41 20 00  
E-mail: [Horizontal.Facility@coe.int](mailto:Horizontal.Facility@coe.int).

© Këshilli i Evropës, prill 2022.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. I liçencuar në Bashkimin Europian sipas kushteve të miratuara.

Ky dokument është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu janë përgjegjësi e autorit dhe nuk mund të merren në asnjë mënyrë si pasqyrim i mendimit zyrtar të asnjërës palë.

# Tabela e Përmbajtjes

---

HYRJE	5
PASQYRË E ÇËSHTJEVE MË TË RËNDËSISHME TË LIDHURA ME LIRINË E SHPREHJES	7
Biancardi k. Italisë, aktgjykim i datës 25 Nëntor 2021, numër kërkesë 77419/16	7
<i>Associazione Politica Nazionale Lista Marco Pannella dhe Radicali Italiani kundër Italisë, aktgjykimi i datës 31 gusht 2021, kërkesa nr. 20002/13, dhe Associazione Politica Nazionale Lista Marco Pannella kundër Italisë, aktgjykimi i datës 31 gusht 2021, kërkesa nr. 66984/14</i>	8
<i>Miroslava Todorova kundër Bullgarisë, aktgjykimi i datës 19 tetor 2021, kërkesa nr. 40072/13</i>	10
<i>Standard Verlagsgesellschaft MbH kundër Austrisë (Nr. 3), vendimi i datës 7 dhjetor 2021, Kërkesa nr. 39378/15</i>	11
<i>Vedat Şorli kundër Turqisë, aktgjykim i datës 19 tetor 2021, kërkesa nr. 42048/19</i>	12
<i>Rovshan Hajiyev kundër Azerbaixhanit, aktgjykimi i datës 9 dhjetor 2021, kërkesa nr. 19925/12 dhe 47532/13</i>	13
ANALIZA E THELLUAR E ÇËSHTJEVE TË PËRZGJEDHURA	15
<i>Shoqata ACCEPT dhe të tjerët kundër Rumanisë, aktvendimi i datës 1 qershor 2021, kërkesa nr. 19237/16</i>	15
<i>Dareskizb kundër Armenisë, aktgjykimi i datës 21 shtator 2021, kërkesa nr. 61737/08</i>	17



# Hyrje

**K**y buletin përgatitet në kuadër të iniciativës së përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019–2022” dhe projektit të tij me temë “**Liria e shprehjes dhe e mediave në Evropën Juglindore (JUFREX).**”

Për të vazhduar bashkëpunimin me profesionistët ligjorë, certifikimin e trajnerëve nga JUFREX dhe kontributin për përmirësimin e mëtejshëm të njohurive në fushën e lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave, kemi përgatitur këtë buletin si një tjetër mjet që shërben për shkëmbimin e informacionit mbi tendencat dhe zhvillimet e reja në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ, Gjykata).

Ndërsa Buletini Nr. 1 mbulonte periudhën prill 2019–korrik 2020, Buletini Nr. 2 periudhën gusht 2020–janar 2021, Buletini Nr. 3, mbulonte periudhën shkurt 2021–korrik 2021, Buletini Nr. 4, përfshin disa nga vendimet relevante të shpallura nga korrik 2021 - janar 2022.

**P**ër periudhën Gusht 2021 – Janar 2022, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (*referuar si Gjykata, ose GJEDNJ*) dha 49 gjykime dhe 17 vendime pranimi lidhur me lirinë e shprehjes<sup>1</sup>. Çështjet e gjykuara kishin të bënin me tematika të ndryshme të përfshira në Nenin 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (*referuar si KEDNJ, ose Konventa*), duke filluar nga ndalimi i medias së shkruar tek aksesit në informacion, si dhe lidhur me çështjet e mbrojtjes dhe privatësisë. Shumica e çështjeve të paraqitura u sollën prej kërkuesve të cilët pretendonin shkelje të lirisë së shprehjes, kurse njëra prej çështjeve kishte të bënte me Nenin 8 nga kërkues që pretendonin se u ishte shkelur e drejta e respektimit të jetës private për shkak të dështimit të autoriteteve të shtetit përkatës për t’i mbrojtur nga gjuha e urrejtjes. Gjykimet kryesisht rikonfirmuan jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Gjykatës, ndërsa disa të tjera qartësuan më tej standardet evropiane.

Në dy çështjet e përzgjedhura për t’u trajtuar më në detaj në këtë Buletin, Gjykata e vë theksin te rëndësia e mbrojtjes së duhur për të drejtat e minoriteteve seksuale, duke përfshirë të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes, si dhe shkallën në të cilën Shtetet mund të kufizojnë lirinë e shprehjes gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Çështja e parë, [Shoqata ACCEPT dhe te Tjerë k. Rumanisë](#)<sup>2</sup> kishte të bënte me një demonstratë ndërhyrëse gjatë shfaqjes së një filmi, ku pasqyrohej një familje me partnerë të të njëjtit seks në kuadër të Muajit Historik të LGBT-së të shoqatës që i ishte drejtuar Gjykatës. Kinemaja ishte pushtuar nga protestues që presupozohej të mbartnin sende me simbole të djathta ekstremiste, pjesëmarrësit ishin dhunuar dhe policia nuk kishte arritur të siguronte mbrojtje dhe të garantonte zhvillimin e aktivitetit edhe pse ishte e pranishme në vendngjarje. I dyti gjykim kryesor i këtij buletini, [Dareskizb](#)

- 1 Sipas sistemit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, çështjet duhet të kalojnë një fazë pranimi. Ndonjëherë kjo çon në marrjen e një vendimi më vete nga ana e Gjykatës, përmes të cilit Gjykata mund të vendosë standarde të rëndësishme, veçanërisht për çështjet e lidhura me “gjuhën e urrejtjes”, te cilat mund të përjashtohen si “abuzim me të drejtat” sipas Nenit 17 të Konventës.
- 2 Vendimi për këtë çështje u mor gjatë gjysmës së parë të vitit të kaluar por nuk u përfshi në buletin e mëparshëm. Për shkak të rëndësisë, u vendos të përfshihet në këtë buletin.

*Ltd k. Armenisë*, kishte të bënte me veprimet e ndërmarra nga autoritetet shtetërore gjatë gjendjes së jashtëzakonshme pas zgjedhjeve presidenciale të vitit 2008, ku kompanisë kërkuese i ishte ndaluar të botonte gazetën e vet.

Ky buletin përmbledh gjithashtu edhe gjashtë çështje të tjera, të cilat kanë të bëjnë me: të ashtuquajturën “e drejtë për t’u harruar”, një fushë e re e jurisprudencës për Gjykatën; transmetimi politik; liria e shprehjes së anëtarëve të gjyqësorit; e drejta e aksesit në informacion; çështja nëse ekziston e drejta e ‘anonimitetit’ në rastin e lënies së komenteve, si edhe kufiri midis diskursit të fortë politik online dhe ‘fyerjes’ së pajustificuar.

Gjithsej, në pothuajse 80% (39 nga 49 çështje) të çështjeve për lirinë e shprehjes të sjella nëpërmjet Nenet 10 të cilat u pranuan nga Gjykata, u gjetën shkelje. Në të gjitha gjykimet e këtyre çështjeve theksohet detyrimi i Shteteve palë të Konventës për respektimin e standardeve të saj në përputhje me parimin e subsidiaritetit. Gjatë vitit 2021 kishte një rritje prej 38% të çështjeve të komunikuar nga Gjykata. Në disa prej gjykimeve të përfshira në këtë Buletin, Gjykata ishte tepër kritike ndaj gjyqësorit apo legjislacionit vendas, si në rastin e *Rovshan Hajiyev k. Azerbajxhanit*, ku Gjykata konstatoi “shkelje të hapur e të pajustificuar në interpretimin dhe aplikimin e ligjit vendas”; apo në çështjen *Vedat Şorli k. Turqisë*, ku Gjykata u shpreh se shteti i akuzuar duhet të heqë nga legjislacioni penal dispozitën që parashikon mbrojtje të posaçme për reputacionin e kreut të shtetit.

Gjatë periudhës objekt i kësaj analize, Dhoma e Madhe e Gjykatës, e cila trajton çështje që ngrenë pikëpyetje serioze mbi interpretimin apo zbatimin e Konventës ose çështje serioze me rëndësi të përgjithshme, pranoi për gjykim dy çështje që iu referuan në lidhje me lirinë e shprehjes. E para, *Hurbain k. Belgjikës* (aktgjykim i datës 22 qershor 2021, numër kërkese 57292/16; referim i pranuar më 11 tetor 2021) ka të bëjë me të ashtuquajturën “të drejtë për t’u harruar”. Kjo çështje u ngrit nga një redaktor gazete, i cili ishte detyruar të anonimizonte një artikull gazete mbi një aksident rrugor, ku një person kishte humbur jetën. Në gjykimin e datës 22 qershor 2021, Seksioni i Tretë i Gjykatës deklaroi se diçka e tillë nuk ishte në shkelje të lirisë së shprehjes. Çështja e dytë, *Sanchez k. Francës* (aktgjykim i datës 2 shtator 2021, numër kërkese 45581/15; referim i pranuar më 17 janar 2022) ka të bëjë me kufirin deri ku mund të mbajë përgjegjësi një politikan për përmbajtje të postuar nga persona të tjerë në faqen e tij në Facebook. Më 2 shtator 2021, Seksioni i Pestë i Gjykatës ishte shprehur se dënimi i politikanit për mosfshirje të gjuhës së urrejtjes nuk përbënte shkelje të lirisë së tij të shprehjes. Tashmë, Dhoma e Madhe e Gjykatës do të duhet t’i shqyrtojë të dyja këto çështje.

Në fund, si njoftim praktik, lexuesit e këtij Buletini që përfaqësojnë kërkuesit në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut, duhet të kenë parasysh se sipas Neneve 4 dhe 8 të [Protokollit nr. 15](#), i cili ka hyrë në fuqi më 1 gusht 2021, afati kohor për depozitimin e kërkesave në Gjykatë është shkurtuar nga 6 në 4 muaj nga marrja e vendimit të formës së prerë nga autoritetet e shtetit përkatës. Kjo vlen për të gjitha vendimet e marra pas datës 1 shkurt 2022.

# Pasqyrë e çështjeve më të rëndësishme të lidhura me lirinë e shprehjes

***Biancardi k. Italisë***, aktgjykim i datës 25 Nëntor 2021, numër kërkesë 77419/16

## Faktet e çështjes

Në Mars 2008, kërkuesi i cili është krye-redaktor i një gazete online, publikoi një artikull mbi një zënkë ku u përdorën edhe thika, në një restorant lokal. Artikulli iu referua me emër restorantit, personave të përfshirë (dy vëllezërve V.X dhe U.X si dhe secilit prej djemve të tyre), duke përmendur edhe detaje të tjera. Në Shtator 2010, V.X. dhe restoranti i dërguan një kërkesë me shkrim kërkuetit duke i kërkuar të hiqte artikullin nga interneti. Duke mos marrë përgjigje, në tetor ata paditën Google Italy (i cili u përjashtua më pas nga gjykimi) si dhe kërkuetin. Gjatë një seance dëgjimore në Maj 2011, kërkuesi rrëfeu se e kishte çindeksuar artikullin nga interneti. Gjykata vendore gjykoi se pavarësisht se nuk kishte pse të shqyrtohej padia lidhur me heqjen e artikullit, kishte patur shkelje të reputacionit të paditësit për periudhën që artikulli mund të aksesohet lehtësisht. Për këtë, Gjykata vendore vendosi një dëmshpërbim monetar prej 5,000 Euro për secilin paditës për dëmin jopasuror të shkaktuar si edhe mbulimin prej 2,300 Euro për kostot dhe shpenzimet. Gjykata arsyetoi se artikulli ishte i aksesueshëm nga Marsi 2008 deri në Maj 2011, dhe se informacioni ishte lehtësisht i aksesueshëm duke futur emrat e paditësve në motorin e kërkimit. Apelimi i vendimit në Gjykatën e Lartë u rrëzua.

Kërkuesi u ankua pranë Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut se e drejta e tij për lirinë e shprehjes ishte shkelur.

## Vendimi i Gjykatës

Gjykata vërejtë se thelbi i çështjes ishte lehtësia e aksesit të artikullit online për një periudhë të gjatë kohore dhe mënyra se si mund të gjendej ai duke kërkuar emrin e personit të përfshirë. Gjykata diskutoi shkurtimisht terminologjinë teknike në fjalë, duke shpjeguar se “çindeksimi” (dhe termat e ngjashëm me të si “çlistim” dhe “çreferencim”) tregojnë heqjen e faqeve specifike të internetit nga rezultatet e kërkimit. Çindeksimi mund të bëhet nga motori i kërkimit, por edhe nga redaktori i gazetës përmes teknikës së “mosindeksimit”. Në këtë rast, redaktorit i ishte bërë kërkesa për çindeksim.

Gjykata ritheksoi parimet që zbatohen zakonisht në rastet kur e drejta për lirinë e shprehjes duhet të balancohet me të drejtën për reputacion, por u shpreh se për shkak të dy veçorive dalluese të këtij rasti – periudhës së aksesueshmërisë së artikullit në internet, dhe faktit që publikimi kishte të bënte me një individ privat që nuk vepron brenda kontekstit publik – zbatimi i rreptë i këtyre kritereve do të ishte i papërshtatshëm. Gjykata vendosi se do të shqyrtonte nëse gjetjet e gjykatave vendase bazoheshin në baza relevante dhe të mjaftueshme, me vëmendje të veçantë për (i) sa kohë artikulli kishte qenë

lehtësisht i aksesueshëm në internet; (ii) ndjeshmërinë e informacionit; dhe (iii) peshën e sanksionit të vendosur ndaj kërkuesit.

Sa i përket pikës së parë, Gjykata vuri në dukje se ndërkohë që procedimi penal mbi zënkën ishte ende pezull, artikulli nuk ishte përditësuar ose hequr, pavarësisht njoftimit zyrtar. Gjykata më pas mori parasysh se precedenti vendas dhe ndërkombëtar shprehej se rëndësia e së drejtës së kërkuesit për të publikuar informacion binte me kalimin e kohës, ndërsa interesat e reputacionit të kërkuesit rriteshin. Gjykata theksoi edhe se natyra e ndjeshme e të dhënave – procedim penal – duhet të merret parasysh. Gjykata vlerësoi gjithashtu se shuma e dëmshpërblimit të dhënë nuk mund të konsiderohej si e tepruar, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes. Së fundmi, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut theksoi se në rastet kur autoritetet kombëtare kanë ushtruar balancimin mes lirisë së shprehjes dhe të drejtës për respektimin e jetës private, atëherë do të duheshin arsye të forta që Gjykata të zëvendësojë pikëpamjen e saj me atë të gjykatave vendase. Për të gjitha këto arsye, Gjykata u shpreh se vendimi i dëmshpërblimit i dhënë nga gjykatat vendase nuk cenonte të drejtën e kërkuesit për lirinë e shprehjes.

**Shënim:** Duke mos konstatuar shkelje të së drejtës për lirinë e shprehjes, Gjykata thekson se “kërkuesit nuk iu imponua asnjë kërkesë për heqjen e përhershme të artikullit nga interneti”. Gjykimi bazohet tek ai çka mund të rezultojë të jetë një mendim pakice influencues nga Gjyqtari Pavli për çështjen [Hurbain k. Belgjikës](#), aktgjykimi i datës 22 qershor 2021, kërkesa nr. 57292/16 (çështje e pranuar për [referim në Dhomën e Madhe](#)). Dy pikat kryesore të interesit janë mënyra se si propozon kritere të reja në rastet e “të drejtës për t’u harruar” që nuk i përshtaten testit të zakonshëm të balancimit të privatësisë kundrejt lirisë së shprehjes (i ashtuquajtur i Von Hannover dhe kriteret përkatëse Axel Springer); dhe fokusi te “çindeksimi” si një masë më pak e ashpër për mbrojtjen e interesave të reputacionit. Megjithatë, arsyetimi i Gjykatës, i cili mund të karakterizohet si disi minimalist, ka tërhequr kritikë. Së pari, marrja në konsideratë e vlerës së

interesit publik të informimit – zakonisht pjesa qendrore e çdo çështjeje të Nenit 10 – mungon në grupin e ri të kriterëve të Gjykatës. Kjo fushë e së drejtës do të vazhdojë të zhvillohet padysim; kapitulli tjetër i mundshëm është vendimi i Dhomës së Madhe për çështjen *Hurbain kundër Belgjikës* (seanca dëgjimore e kësaj çështjeje, e cila ka të bëjë me një urdhër gjykatë për anonimizimin e një artikulli gazete në internet të botuar njëzet vite më parë, do të mbahet më 9 mars dhe gjykimi mund të pritët më vonë gjatë këtij viti).

**[Associazione Politica Nazionale Lista Marco Pannella dhe Radicali Italiani kundër Italisë](#), aktgjykimi i datës 31 gusht 2021, kërkesa nr. 20002/13, dhe [Associazione Politica Nazionale Lista Marco Pannella kundër Italisë](#), aktgjykimi i datës 31 gusht 2021, kërkesa nr. 66984/14**

#### Faktet e çështjes

**K**ërkuesit në këto çështje janë shoqata politike. Çështja e parë (kërkesa nr. 20002/13) ka të bëjë me ndërprerjen e programeve televizive politike të njohura si “platforma politike”; çështja e dytë (kërkesa nr. 66984/14) kishte të bënte me ankesën se përfaqësuesit e njërës prej shoqatave nuk ishin ftuar të paraqiteshin në emisionet më të rëndësishme të lajmeve të transmetuara nga televizioni publik RAI, dhe se fushatat dhe iniciativat ndërgjegjësuere të saj nuk ishin paraqitur.

Në çështjen e dytë, kërkuesi kishte bërë ankesë zyrtare pranë Autoritetit Rregullator të Komunikimeve, AGCOM. Autoriteti e kishte refuzuar ankesën me arsyetimin se faktikisht shoqata kishte pasur prezencë të mjaftueshme të ngjashme me atë të lëvizjeve të tjera politike që nuk kishin përfaqësues në parlament. Arsyetimi i AGCOM ishte rrëzuar nga gjykata vendase jo një herë, por dy herë, dhe në kohën kur kërkuesi u ftua në programet televizive në fjalë kishin kaluar më shumë se dy vjet dhe një



nga programet ishte anuluar. Kërkuesit nuk iu dha as koha kompensuese e transmetimit.

Kërkuesit u ankuan në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut për shkelje të së drejtës së tyre për lirinë e shprehjes.

### Arsyetimi i gjykatës

**S**a i përket çështjes së parë (kërkesa nr. 20002/13), Gjykata vërejti se në sistemin italian që vepronte përpara se të anulohet, organizimi i “platformave politike” në kanalet shtetërore kërkonte udhëzim nga një komision parlamentar. Gjykata vuri në dukje se sistemi i “platformave politike” daton në fillim të viteve 1970, kur shoqëria dhe media ishin shumë të ndryshme. Publiku nuk ishte më i interesuar për programe të tilla që ishin zëvendësuar tashmë me një gamë më të gjerë programesh informative që u jepnin partive politike mundësinë t’i përcillnin mendimet dhe idetë e tyre në një mënyrë tjetër. Kërkuesi nuk kishte qenë i vetmi grup i prekur nga diçka e tillë: të gjitha grupet dhe partitë politike që kishin marrë pjesë në to ishin prekur në të njëjtën mënyrë. Gjykata vazhdoi të vinte në dukje se zëvendësimi i këtyre “platformave politike” me debate më të thelluara politike i kishte dhënë RAI-t liri më të madhe editoriale dhe i kishte ofruar mundësi të tjera për të dhënë ide dhe opinione politike përmes mediave transmetuese. Ndërprerja e programit të “platformës politike” ishte pjesë e zhvillimit të njohjes së autonomisë editoriale të secilit kanal dhe nuk cenoi të drejtën e kërkuesit për lirinë e shprehjes.

Megjithatë, Gjykata konstatoi shkelje të Nenit 13 (e drejta për zgjidhje juridike efektive): sipas sistemit ligjor italian, nuk mund të ankimohej vendimi i komisionit parlamentar (i cili shprehte vullnetin e parlamentit) për grupe si ato të aplikantit.

Në çështjen e dytë (kërkesa nr. 66984/14), Gjykata vuri në dukje se aplikanti ishte ankuar tek Autoriteti Rregullator i Komunikimeve, AGCOM, i cili, në dy raste, kishte refuzuar të merrte masa, pavarësisht urdhrave të gjykatës. Vetëm në vitin 2013, pasi në gjykatat vendas ishte depozituar çështja e dytë për moszbatim të vendimit të parë,

përfaqësuesit e kërkuesit u ftuan në dy nga programet televizive të transmetuesit publik.

Gjykata konsideroi se qasja e AGCOM kishte qenë tepër formale. Ajo kishte kryer një vlerësim të përgjithshëm të prezencës së shoqatës kërkuese në të gjitha programet aktuale të kanaleve në fjalë, pa marrë parasysh kohën e shfaqjes së programeve apo popullaritetin e tyre. Gjykata vërejti gjithashtu edhe mospërputhje mes detyrës së transmetuesit publik për të përfaqësuar opinione të ndryshme politike në mënyrë të balancuar, dhe praktikës ku grupet e klasifikuara si “subjekte politike” kishin qasje preferenciale në programe të caktuara aktualiteti. Si rezultat, shoqata kërkuese kishte munguar në tre programe televizive shumë të njohura dhe e kishte gjetur veten efektivisht të marginalizuar në mbulimin mediatik. Në momentin që u ftua aplikanti, transmetoheshin vetëm dy nga programet, pasi i treti ishte anuluar. Aplikantit nuk iu dha kohë alternative transmetimit dhe si përfundim, shoqata kërkuese u shfaq vetëm në një nga programet. Për të gjitha këto arsye, Gjykata konstatoi se e drejta e kërkuesit për lirinë e shprehjes ishte shkelur.

**Shënim:** Në të dyja rastet, Gjykata theksoi fuqimisht rëndësinë e pluralizmit në median transmetuese, dhe veçanërisht në transmetimin publik. Programet politike kanë evoluar nga ditët kur ofroheshin “platforma politike” jashtë periudhave zgjedhore drejt njohjes së një lirie më të madhe editoriale për transmetuesin shtetëror (që Gjykata e pranon se është një proces i vazhdueshëm) dhe lejimit të lëvizjeve politike që të paraqesin idetë dhe opinionet e tyre në politikë dhe në lajme dhe programe mbi aktualitetin. Megjithatë, është thelbësore që të ketë barazi në përfaqësim. Formulatat matematikore që e llogarisin kohën si përqindje të kohës së përgjithshme të transmetimit nuk kanë gjasa të ndihmojnë për arritjen e një barazie të tillë, duke pasur parasysh dallimet në popullaritetin e programeve të ndryshme dhe orën e transmetimit të tyre. Çdo qasje që rezulton në përshtatimin apo marginalizim *de facto* të grupeve apo lëvizjeve të caktuara politike ka të ngjarë të cenojë të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes.

## **Miroslava Todorova kundër Bullgarisë, aktgjykimi i datës 19 tetor 2021, kërkesa nr. 40072/13**

### **Faktet e çështjes**

**N**ë cilësinë e saj si Presidente e Unionit Bullgar të Gjyqtarëve, kërkuësja kishte kritikuar shpesh organin disiplinor për gjyqësorin, Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ). Ndaj saj ishte depozituar një ankesë nga një koleg gjyqtar për vonesa në nxjerrjen e vendimeve, dhe në procedimet disiplinore të mëvonshme, KLGJ-ja konstatoi se kërkuësja kishte vonuar dhënien e vendimeve gjyqësore ose zbardhjen e arsyetimeve në 57 raste, që përbën mosrespektim sistematik të afateve, dhe fillimisht vendosi t'i ulte rrogën dhe më pas rekomandoi shkarkimin e saj. Apelimi i saj kundër uljes së pagës përfundimisht u hodh poshtë; dhe megjithëse e fitoi apelimin për shkarkimin e saj, ndaj saj u mor vendim që të ulej në një gjykatë të nivelit më të ulët për një periudhë prej dy vjetësh. Kërkuësja u ankua në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut për shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë, së drejtës për respektim të jetës private, të drejtës për lirinë e shprehjes, së drejtës për mosdiskriminim, si dhe për shkelje të ndalimit të vendosjes së kufizimeve ndaj të drejtave për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat ato janë parashikuar.

### **Arsyetimi i gjykatës**

**G**jkata nuk konstatoi shkelje të së drejtës së kërkuësës për një gjykim të drejtë ose të së drejtës për respektim të jetës private. Duke marrë parasysh ankesën e saj sipas Nenit 10, i cili mbron të drejtën e lirisë së shprehjes, Gjykata vlerësoi se procedimi disiplinor kundër kërkuësës kishte qenë i lidhur me deklaratat e saj publike. Kjo do të thoshte se procedimi disiplinor dhe sanksioni i vendosur ndaj saj mund të kishin pasur një efekt frenues si për kërkuësen, ashtu edhe për gjyqtarë të tjerë. Edhe pse kërkuësja kishte fituar në fund apelin kundër vendimit të gjykatës për shkarkimin e saj nga puna, urdhëri fillestar i shkarkimit kishte hyrë në fuqi menjëherë dhe ajo ishte shkarkuar nga detyra për një vit.

Përveç kësaj, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut u shpreh se gjykatat vendase nuk i kishin shoqëruar vendimet e tyre me arsytetime relevante dhe të mjaftueshme për të shpjeguar se pse kishin qenë të nevojshme dhe proporcionale procedurat disiplinore dhe sanksionet e vendosura. Duke pasur parasysh rëndësinë themelore të lirisë së shprehjes për çështjet me interes publik si funksionimi i sistemit të drejtësisë dhe nevoja për mbrojtjen e pavarësisë së gjyqësorit, Gjykata konstatoi si rrjedhim shkeljen e të drejtës së kërkuësës për lirinë e shprehjes.

Në mënyrë të pazakontë, Gjykata konstatoi edhe një shkelje të Nenit 18 të Konventës, i cili ndalon kufizimin e të drejtave për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë parashikuar. Ajo vlerësoi se ky përbënte një aspekt themelor të çështjes. Gjykata vuri në dukje se kishte pasur polemika midis Unionit Bullgar të Gjyqtarëve dhe ekzekutivit: Ministri i Brendshëm kishte bërë disa deklaratat për shtyp, përmes së cilave e kishte vënë në shënjestër kërkuësen dhe e kishte kritikuar. Këshilli i Lartë Gjyqësor kishte qenë veçanërisht i ashpër në kritikën ndaj kërkuësës dhe ashpërsia e jashtëzakonshme dhe natyra disproporcionale e sanksionit fillestar të shkarkimit ishte vënë re nga pjesë të gjera të shoqërisë bullgare dhe asaj ndërkombëtare. Asnjë nga deklaratat që kishte bërë kërkuësja nuk kishte qenë e paligjshme apo e papajtueshme me kodin e etikës gjyqësore dhe ishte alarmante që për t'u hakmarrë ndaj saj ishte përdorur procedura disiplinore. Duke pasur parasysh të gjitha faktet e çështjes, Gjykata vlerësoi se qëllimi kryesor i procedimit disiplinor kishte qenë penalizimi dhe frikësimi i kërkuësës, duke përbërë shkelje të Nenit 18 të lexuar së bashku me Nenin 10.

Gjykata çmoi se nuk kishte lindur një çështje më vete sipas Nenit 14 (e drejta për mosdiskriminim në gëzimin e të drejtave).

**Shënim:** Anëtarët e gjyqësorit pritet të ushtrojnë njëfarë moderimi në deklaratat e tyre, veçanërisht nëse mund të vihet në pikëpyetje autoriteti ose pavarësia e tyre (shih [Wille kundër Lihtenshtajnit](#), vendimi i 28 tetorit 1999, kërkesa nr. 28396/95), por siç konstatoi edhe Gjykata, asgjë në deklaratat e aplikantes nuk ishte e paligjshme apo jo-etike. Megjithëse Gjykata vërejti se kishte vërtet

vonesa në nxjerrjen e disa vendimeve, sanksioni që ishte vendosur ndaj saj kishte qenë jashtëzakonisht i ashpër. Kjo e çoi Gjykatën në konstatimin e shkeljes së Nenit 18: me pak fjalë, kjo do të thotë se një kufizim i vendosur në dukje për një qëllim, i shërbente në fakt një qëllimi të paligjshëm (në këtë rast, ndëshkimit të gjyqtarës dhe dhënies së një shembulli të tjerëve). Shkeljet e Nenit 18 tregojnë një mosfunksionim serioz të shtetit të së drejtës dhe me këtë gjykim Bullgaria i bashkohet një grupi të vogël vendesh që konstatohet se e kanë shkelur këtë dispozitë (të tjerat janë Azerbajxhani (me njëmbëdhjetë shkelje), Gjeorgjia, Rusia, Turqia, dhe Ukraina (me dy ose tre shkelje secila) dhe Republika e Moldavisë (me një shkelje). Ky duhet të jetë shkak për një shqetësim të fortë dhe mund të pritët që Komiteti për Ekzekutimin e Vendimeve të Këshillit të Evropës ta vendosë këtë çështje nën një mbikëqyrje të shtuar.

**Standard Verlagsgesellschaft MbH kundër Austrisë (Nr. 3), vendimi i datës 7 dhjetor 2021, Kërkesa nr. 39378/15**

#### Faktet e çështjes

**K**ërkuesi është botuesi i një gazete dhe i një portali online që përmban artikuj dhe forumë diskutimi. Kur regjistrohen si përdorues në këtë faqe interneti, gjë që u lejon të bëjnë komente në lidhje me artikujt e publikuar, njerëzve u kërkohet të japin emrat dhe adresat e tyre të emailit, dhe, nëse dëshirojnë, edhe adresat postare. Në faqen e internetit bëhej e qartë se kompania kërkuese në këtë çështje do ta bënte publik këtë informacion vetëm nëse kjo gjë kërkohet me ligj. Moderatorët shqyrtonin rreth 6000 komente në ditë, duke fshirë shumë prej tyre dhe kompania u jepte të dhëna të përdoruesve autoriteteve përkatëse kur ishte e qartë se ato ishin në shkelje të të drejtave.

Dy artikuj për politikanët kishin tërhequr komente negative. Në njërin prej tyre thuhej “politikanët e korruptuar-bastardë harrojnë, [por] ne jo. DITA E ZGJEDHJEVE ËSHTË DITA E SHPAGIMIT!!!”; dikush tjetër kishte sugjeruar se një parti politike duhej të ishte “ndaluar për shkak të ringjalljes së

vazhdueshme të nazizmit”; kurse një i tretë kishte deklaruar, “ nëse nuk e keqkuptojmë vazhdimisht [kuptimin e] lirinë e shprehjes dhe nëse cenimi i kushtetutës dhe destabilizimi i formës së qeverisjes do të bëhej rrjedhimisht i dënueshëm – ose të paktën, nëse [ligji anti-mafia] do të zbatohet një herë në skenën e ekstremit të djathtë në Austri – atëherë [H.K.] do të ishte një nga kriminelët më të mëdhenj në Republikën e Dytë”.

Pas disa ankesash, këto komente ishin fshirë, por kompania nuk kishte pranuar të zbulonte identitetin e komentuesve. Gjykatat vendase urdhëruan zbulimin e detajeve të përdoruesve, duke u shprehur se partitë politike dhe politikanët e kritikuar në ato komente kishin një interes mbi-zotërues në nxjerrjen e atyre detajeve. Kërkuesi u ankua në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duke argumentuar se urdhri për zbulimin e të dhënave personale të përdoruesve të portalit të tij të lajmeve ishte në shkelje të së drejtës së tij për lirinë e shprehjes.

#### Arsyetimi i gjykatës

**G**jkata i kushton një diskutim të rëndësishëm çështjes nëse ka pasur ndërhyrje në të drejtën e lirisë së shprehjes të kompanisë ankuese në faqen e së cilës ishin publikuar komentet. Ajo konstatoi se megjithëse komentuesit nuk mund të konsideroheshin si “burime”, siç kishte argumentuar kërkuesi, kishte prapëseprapë një lidhje të fortë midis publikimit të artikujve nga kërkuesi dhe komenteve që artikujt kishin tërhequr. Funkcioni i përgjithshëm i kërkuesit ishte të hapte më tej diskutimin dhe të shpërndante ide dhe informacione në lidhje me temat me interes për publikun dhe detyrimi për zbulimin e informacioneve të përdoruesve do të kishte një efekt frikësues në debatin publik. Gjykata ritheksoi se e drejta për anonimitet, edhe pse jo absolute, ishte një pasojë e së drejtës për lirinë e shprehjes: ajo ishte një mënyrë e rëndësishme për të shmangur hakmarrjet ose vëmendjen e padëshiruar, dhe nxiste shprehjen e lirë të opinionëve, ideve dhe informacionit. Ky anonimitet nuk do të ishte efektiv nëse kompania kërkuese nuk do të mund ta mbronte; kështu që urdhri për heqjen e anonimitetit kishte ndërhyrë në këtë mënyrë në të drejtën e kërkuesit për lirinë e shprehjes.

Pas "testit tre-pjesësh" të zakonshëm, Gjykata çmoi se kjo ndërhyrje ishte parashikuar me ligj për qëllimin legjitim të mbrojtjes së reputacionit të të tjerëve; ajo shkoi më tej, duke konsideruar nëse ndërhyrja kishte qenë "e nevojshme në një shoqëri demokratike". Gjykata vuri në dukje se komentet në fjalë nuk përbënin as gjuhë urrejtjeje dhe as nxitje për dhunë, por kishin të bënin me dy politikanë dhe me një parti politike në një debat politik me interes për publikun. Gjykatat vendase duhet të kishin balancuar interesat konkurruese të reputacionit dhe lirisë së shprehjes. Ato nuk e kishin bërë këtë dhe nuk kishin dhënë asnjë arsye se përse interesat e reputacionit të paditësve kishin peshuar më shumë se interesat e kërkuesit për të mbajtur sekret identitetin e përdoruesve të tij. Për ushtrimin e ekuilibruar të interesave në procedim në lidhje me zbulimin e të dhënave të përdoruesit, mund të mjaftojë një ekzaminim *a prima facie*, por edhe kjo kërkon të paktën njëfarë arsyetimi. Mosvendosja e këtij ekuilibri nga gjykatat ka shkelur të drejtën e lirisë së shprehjes së kërkuesit.

**Shënim:** Kjo është e para çështje ku Gjykata shqyrton në mënyrë eksplicite nëse detyrimi i mediave online për të zbuluar të dhënat e përdoruesve përbën shkelje të së drejtës së lirisë së shprehjes (në disa çështje të mëparshme – [\[DHM\] Delfi AS kundër Estonisë](#), vendimi i 16 qershorit 2015, kërkesa nr. 64569/09, dhe [Magyar Tartalom-szolgáltatók Egyesülete dhe Index.hu Zrt kundër Hungarisë](#), aktgjykimi i datës 2 shkurt 2016, kërkesa nr. 22947/13 – nuk ishte ngritur kjo pikë). Këtu, Gjykata vlerëson se forumet online janë pjesë integrale të funksionimit të lajmeve të kërkuesit: aty ftohen lexuesit të bëjnë komente, ofrohet një proces regjistrimi dhe moderohet një numër i madh komentesh (në fakt, kërkuesi vërtet që i kishte fshirë komentet në fjalë me marrjen e ankesave për to). Në nivel vendor, kompania kërkuese ishte përpjekur të kapej pas argumentit të mbrojtjes së burimeve për të mos nxjerrë të dhënat e përdoruesve. Diçka e tillë nuk kishte funksionuar në gjykatat vendase dhe as Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk e pranoi këtë linjë arsyetimi, por u shpreh, nga ana tjetër, se qasja e integruar e medias ndaj komenteve dhe artikujve të lajmeve së bashku me rëndësinë e anonimite-

tit, nënkuptonte se kjo gjë mund të bënte që ajo t'i referohej të drejtës së saj për lirinë e shprehjes për të kundërshtuar zbulimin e të dhënave të përdoruesit. Në të njëjtën kohë, Gjykata nuk vendos pengesë të lartë për zbulimin e informacionit, duke theksuar se "për ushtrimin e balancimit të interesave lidhur me procedurat për zbulimin e të dhënave të përdoruesit, mund të mjaftojë kontrolli *prima facie*". Por, Gjykata vazhdon të vërejë se "edhe për kontrollin *prima facie* nevojitet arsyetimi dhe balancimi". Gjyqtari Eicke kundërshton pikën e pranueshmërisë, duke shqyrtuar legjislacionin e BE-së (sigurisht është e vërtetë që ky vendim ngre pyetje) dhe duke paralajmëruar për ndikimin e mundshëm negativ mbi aftësinë e viktimeve të postimeve abuzive për të fituar akses në drejtësi.

### **Vedat Şorli kundër Turqisë,** **aktgjykim i datës 19 tetor 2021,** **kërkesa nr. 42048/19**

#### **Faktet e çështjes**

**K**ërkuesi ishte dënuar me 11 muaj e 20 ditë burg, me pezullim të ekzekutimit të vendimit për pesë vjet (që do të thotë se nëse kërkuesi nuk do të kryente vepra penale të tjera të qëllimshme gjatë kësaj periudhe, atëherë dënimi do të anulohet) për fyerje të Presidentit në dy postime në Facebook. Ai u mbajt në paraburgim për dy muaj e dy ditë.

Postimi i parë në Facebook ishte një karikaturë që tregonte presidentin e atëhershëm të SHBA-së, Barack Obama, duke puthur Presidentin e Turqisë, i paraqitur me veshje femërore, me mbi-shkrim që thoshte "A do ta regjistrosch pronësinë e Sirisë në emrin tim, burri im i dashur?" Postimi i dytë tregonte fotot e Presidentit të Turqisë me komentin e mëposhtëm: "U varrostë fuqia juaj e mbushur me gjak në thellësitë e tokës/U varrosshin në thellësitë e tokës postet që mbani duke marrë jetë/ U varrosshin në thellësitë e tokës jetët e luksit që bëni falë ëndrrave të vjedhura/U varrostë në thellësitë e tokës presidenca juaj, fuqia juaj dhe ambiciet tuaja".

Apelimet e kërkuessit në sistemin gjyqësor vendor ishin të pasuksesshme; ai u ankua në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut për shkelje të së drejtës së tij për lirinë e shprehjes.

### Arsyetimi i gjykatës

**G**jkata vërejti se aplikanti ishte dënua në bazë të një dispozite të Kodit Penal që i siguronte Presidentit të Republikës një shkallë më të lartë mbrojtjeje se sa të tjerëve dhe që parashikonte dënime më të rënda. Gjykata theksoi se në shumë çështje të tjera të mëparshme kundër Turqisë si dhe kundër vendeve të tjera, kishte vendosur se këto ligje nuk janë në përputhje me kërkesat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (duke i referuar ndër të tjera çështjes [Colombani dhe të Tjerët kundër Francës](#), aktgjykimi i datës 25 qershor 2002, kërkesa nr. 51279/99, [Otegi Mondragon kundër Spanjës](#), aktgjykimi i datës 6 nëntor 2018, kërkesa nr. 2034/07; [Artun dhe Güvener kundër Turqisë](#), aktgjykimi i datës 26 qershor 2007, kërkesa nr. 75510/01).

Gjykata vazhdoi të shqyrtonte dënimin e ashpër penal të vendosur ndaj kërkuessit. Ajo theksoi se personat që përfaqësojnë institucionet shtetërore duhet të tregojnë vetëpërbajtje kur i drejtohen procedimeve penale për mbrojtjen e reputacionit të tyre. Gjykata theksoi edhe kur dënimi i vendosur është me i lehti i mundshëm, si p.sh. një vendim fajësie me lirim apo gjobë simbolike prej vetëm 1 €, ai përbën dënim penal. Gjykata vendosi theksin tek efekti frenues që kanë dënimet penale për të drejtën e lirisë së shprehjes. Duke i rikthyer fakteve të çështjes në fjalë, Gjykata vlerësoi se nuk u gjet asnjë justifikim për vendosjen e kërkuessit nën kontroll policor ose në paraburgim dhe as për dhënien e dënimeve penale, si dhe konstatoi shkelje të së drejtës për lirinë e shprehjes.

Më pas, Gjykata vazhdoi me shqyrtimin e Nenit 46 të Konventës, i cili parashikon se shtetet duhet t'u binden vendimeve gjyqësore. Duke theksuar se themeli i çështjes bazohet tek dispozita penale që i jepte mbrojtje të shtuar reputacionit të kreut të shtetit, Gjykata u shpreh se do të ishte i përshtatshëm reformimi i këtij ligji për ta sjellë në përputhje me Nenin 10 të Konventës.

**Shënim:** Fyerja e kreut të shtetit është vepër penale në disa vende evropiane. Ndonëse ndjekjet penale janë të rralla, ligje të tilla kanë efekt frenues mbi të drejtën e lirisë së shprehjes dhe, siç vëren edhe Gjykata, "nuk janë, në parim, në përputhje me frymën e Konventës". Gjykata thekson edhe nevojën për të kufizuar maksimalisht përdorimin e së drejtës penale për mbrojtjen e reputacionit të zyrtarëve publikë, duke theksuar se edhe një dënim i lehtë mbetet sërish dënim penal. Gjykata i ka shqyrtuar të dyja këto pika më parë (shih çështjet e përmendura në përmbledhjen e çështjeve më lart), dhe Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës ka bërë një deklaratë duke kërkuar të njëjtën gjë që prej vitit 2004 ([Deklarata për lirinë e debatit politik në media](#), miratuar më 12 shkurt 2004), megjithatë, reforma ligjore ka qenë e ngadaltë. Konstatimi i Gjykatës sipas Nenit 46 lidhur me faktin se reforma ligjore do të ishte e përshtatshme, thekson urgjencën e reformës së kërkuar dhe duhet të merret parasysh nga shtetet e tjera që kanë ende ligje të ngjashme në legjislacionet e tyre.

**[Rovshan Hajiyev kundër Azerbajxhanit](#), aktgjykimi i datës 9 dhjetor 2021, kërkesa nr. 19925/12 dhe 47532/13**

### Faktet e çështjes

**K**ërkuessi, redaktor i një gazete kombëtare, bëri dy kërkesa për akses në informacion në lidhje me kërcënimet e mundshme mbi shëndetin publik dhe mbi mjedisin që paraqiste një stacion radari ushtarak i epokës sovjetike në Azerbajxhan, i cili operohej nga Rusia deri në vitin 2012. Studime të pavarura sugjeronin se stacioni kishte shkaktuar probleme serioze të shëndetit publik dhe Presidenti i Azerbajxhanit kishte caktuar dy komisione për vlerësimin e këtyre rreziqeve në vitin 2001 dhe në 2003. Në vitin 2010, kërkuessi pyeti Ministrinë e Shëndetësisë nëse komisionet vazhdonin të ishin aktive dhe çfarë raportesh ishin përgatitur. Ai u informua se ishte hartuar një raport dhe i ishte transmetuar Kabinetit të Ministrave, por nuk ishte më në po-

sedim të ministrisë dhe rrjedhimisht nuk mund të sigurohej. Përpjekjet përmes gjykatave për të detyruar paraqitjen e raportit ishin të kota. Kërkuksi i bëri një kërkesë të veçantë Kabinetit të Ministrave, i cili nuk dha përgjigje. “Mospërgjigja” u mbështet nga gjykatat të cilat argumentuan se sipas legjislacionit mbi aksesin në informacion të Azerbajxhanit, nuk kishte asnjë detyrim për të zbuluar raportet e komisioneve të krijuara për qëllime të caktuara. Kërkuksi u ankua në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut për shkelje të së drejtës së tij për lirinë e shprehjes.

### Arsyetimi i gjykatës

**F**illimisht, Gjykata shqyrtoi nëse çështja ishte e pranueshme. Ajo theksoi se e drejta e aksesit në informacionin e mbajtur nga një autoritet publik mund të lindë në bazë të Nenit 10 kur informacioni i kërkuar është instrumental për ushtrimin e së drejtës për lirinë e shprehjes. Kriteret që duhen zbatuar në raste të tilla janë (a) qëllimi i kërkesës për informacion; (b) natyra e informacionit të kërkuar; (c) roli i kërkuksit; dhe (d) nëse informacioni i kërkuar është gati dhe i disponueshëm. Gjykata vuri në dukje se kërkuksi ishte gazetar dhe se ai kishte informuar shprehimisht autoritetet përkatëse shtetërore se i nevojitej informacioni për punën e tij si gazetar. Gjykata deklaroi se natyra e informacionit ishte qartësisht e një rëndësie të përgjithshme publike, dhe raporti në fjalë ishte, në parim, gati dhe i disponueshëm. Vënia e tij në dispozicion nuk duhet të kishte paraqitur vështirësi praktike ose barrë të paarsyeshme për autoritetet përkatëse. Rrjedhimisht, Neni 10 ishte i zbatueshëm; refuzimi përbënte ndërhyrje në të drejtat e kërkuksit.

Teksa shqyrtonte nëse refuzimi mund të justifikohet, Gjykata u përqendrua te fakti nëse ai ishte “i parashikuar me ligj”, siç kërkohet sipas Nenit 10(2) të Konventës. Duke marrë parasysh, së pari, ligjshmërinë e përgjigjes së dhënë nga Ministria e Shëndetësisë, Gjykata vuri në dukje se gjykatat vendase nuk kishin trajtuar faktin nëse ajo ishte në përputhje me legjislacionin e brendshëm (që i kërkonte Ministrisë, nëse ajo nuk e kishte vërtet raportin, por e dinte se cili organ shtetëror e kishte, ta përcillte kërkesën tek autoriteti kompe-

tent me iniciativën e saj). Po ashtu, mospërgjigja e Kabinetit të Ministrave ishte në kundërshtim me ligjin e brendshëm, sipas të cilit refuzimi i dhënies së aksesit në informacion duhet të bëhej me shkrim dhe në mënyrë të argumentuar. Gjykatat vendase nuk kishin arritur t’i zgjidhnin këto mangësi. Gjykata u shpreh gjithashtu se mbështetja e gjykatave vendase mbi një dispozitë të së drejtës së brendshme që nuk kërkonte publikimin proaktiv të raporteve të komisioneve të krijuara për një qëllim të caktuar ishte haptazi e paarsyeshme: kjo dispozitë nuk kishte për qëllim të kufizonte aksesin tek informacionet e mbajtura nga shteti. Përkundrazi, ajo lehtësonte këtë akses duke u kërkuar zotëruesve të informacionit të zbulonin lloje të caktuara informacionesh të kërkuara shpesh për publikun në përgjithësi. Aksesin në informacione që nuk i përkisnin llojeve të renditura specifikisht në këtë dispozitë mund të kërkohej rast pas rasti, përmes kërkesave si ajo e bërë nga kërkuksi në fjalë. Prandaj, nuk kishte bazë ligjore për mohimin e informacionit, duke çuar në shkelje të së drejtës së kërkuksit për lirinë e shprehjes.

**Shënim:** Kërkuksi u gjend në një situatë të tipit “Kafka” ku Ministria e Shëndetësisë mohoi që ta kishte ende raportin; Kabineti i Ministrave, i cili e kishte raportin, refuzoi të përgjigjej; dhe gjykatat vendase vulosën mosveprimet e institucioneve shtetërore, sipas fjalëve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, përmes “interpretimit dhe zbatimit qartazi të paarsyeshëm të legjislacionit të brendshëm”. Dikur ishte mjaft e rrallë që Gjykata të konstatonte shkelje të së drejtës së lirisë së shprehjes mbi bazën që një ndërhyrje nuk ishte “e parashikuar me ligj” (këto raste tregojnë, potëhuajse gjithmonë, dështime mjaft thelbësore të shtetit të së drejtës). Megjithatë, në katër vitet e fundit, ajo ka konstatuar shkelje të ngjashme në 44 raste, ku vetëm Rusia dhe Turqia janë gjetur në shkelje më shpesh se Azerbajxhani. Pak muaj para këtij aktgjykimi, i njëjti seksion i Gjykatës e cilësoi arrestimin, ndalimin dhe dënimin e paligjshëm të aktivistëve të opozitës për shpërndarjen e fletëpalosjeve antiqeveritare si “akt arbitrar flagrant dhe mohim i vetë thelbit të lirisë së shprehjes” ([Hasanov dhe Majidli kundër Azerbajxhanit](#)), aktgjykimi i datës 7 tetor 2021, kërkesa nr. 9626/14 dhe 9717/14).

# Analiza e thelluar e çështjeve të përzgjedhura

**Shoqata ACCEPT dhe të tjerët kundër Rumanisë, aktvendimi i datës 1 qershor 2021, kërkesa nr. 19237/16**

## Faktet e çështjes

**K**ërkuesit janë një shoqatë jofitimprurëse që promovon interesat e personave lezbikë, homoseksualë, biseksualë dhe transjinatorë (LGBT) në Rumani, dhe pesë shtetas rumunë. Gjatë muajit të historisë LGBT të shoqatës në shkurt të vitit 2013, në Muzeun Kombëtar të Fshatarëve në Rumani u shfaq një film që përfshte një familje të të njëjtit seks. Pesë kërkuesit e tjerë e ndoqën shfaqjen. Shfaqja ishte menduar të pasohet nga një diskutim mes të pranishmëve, i frymëzuar nga filmi, për të drejtat e familjeve të të njëjtit seks. Përpara ngjarjes, kërkuesi mësoi se po ndodhte një “mobilizim online” në platformat e mediave sociale, i cili bënte thirrje për demonstratë gjatë shfaqjes së filmit në muze. Shoqata kërkuese kërkoi mbrojtje nga policia dhe në korridorin jashtë sallës së shfaqjes u vendosën dhjetë oficerë së bashku me një ekip prej shtatë xhandarësh të lajmëruar nga drejtori i Muzeut.

Rreth njëzet persona e ndoqën shfaqjen dhe shumica prej tyre ishin të ftuar. Pak para fillimit të shfaqjes, hynë një grup prej pesëdhjetë vetash, disa prej të cilëve mbanin shtiza flamuri, duke bërë thirrje të tilla si “vdekje homoseksualëve”, “peder”, “i ndyrë”, si dhe duke fyer e kërcënuar të pranishmit. Disa prej tyre shfaqnin shenja fashiste dhe ksenofobike, si dhe tundnin flamurin e një partie të ekstremit të djathtë. Personat që u futën dukej se ishin të lidhur me një lëvizje të ekstremit të djathtë, e cila kundërshtonte hapur,

ndër të tjera, martesat mes çiftëve të të njëjtit seks dhe birësimet nga çiftet e të njëjtit seks. Organizatorët njoftuan oficerët e policisë që ishin vendosur jashtë sallës së shfaqjes. Ata hynë, konfiskuan disa flamuj dhe më pas u larguan nga dhoma, pavarësisht kërkesës së organizatorëve për të qëndruar. Personat që u futën më pas bllokuan projektorin, duke i detyruar organizatorët të ndalonin shfaqjen. Ndërsa njerëzit filluan të dilnin nga salla, oficerët e policisë të vendosur në korridor kontrolluan dokumentat e identitetit të njëzet e nëntë individëve, shumica prej të cilëve nga grupi kundër shfaqjes.

Më 5 mars 2013, shoqata kërkuese u ankua në polici për incidentin, duke pretenduar nxitjen për diskriminim, shpërdorimin e detyrës nga kufizimi i të drejtave dhe shfaqjen e simboleve fashiste, raciste ose ksenofobike në publik. Hetimi u hap dhe u mbyll përfundimisht në nëntor të vitit 2017, pa marrë asnjë masë. Disa ankesa që kërkuesit kishin dërguar në gjykata ishin pa rezultat.

## Arsyetimi i gjykatës

**K**ërkuesit u ankuan në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut për shkelje të së drejtës së tyre për respektimin e jetës private, të drejtës së tyre për lirinë e tubimit dhe të drejtës së tyre për mbrojtjen nga diskriminimi (sipas neneve 8, 11 dhe 14 të Konventës dhe nenit 1 i Protokollit nr. 12 të Konventës).

Gjykata theksoi detyrën e autoriteteve për të parandaluar krimet e urrejtjes (qofshin ato sulme fizike apo abuzime verbale) dhe për të hetuar ekzistencën e çdo motivi të mundshëm diskriminues

që qëndron pas dhunës. Duke e trajtuar çështjen në bazë të neneve 8 dhe 14, të cilat mbrojnë të drejtën për respektimin e jetës private dhe të drejtën për gëzimin pa diskriminim të të drejtave të konventës, Gjykata theksoi se shtetet duhet të kenë një sistem legjislativ penal që përbën parandalimin efektiv të akteve të individëve private që cenojnë aspekte thelbësore të jetës private. Kjo përfshin vendosjen e dënimeve efektive penale kundër gjuhës së urrejtjes dhe nxitjes së dhunës. Përveç kësaj, shtetet kanë për detyrë të ofrojnë mbrojtje, si dhe të hetojnë incidentet e gjuhës së urrejtjes.

Sa i përket detyrimit për mbrojtje, Gjykata vërejt se numri i oficerëve të policisë dhe xhandarëve të pranishëm ishte i mjaftueshëm që prej fillimit të incidentit. Ata nuk u mposhtën dhe as nuk u kapën të papërgatitur. Megjithatë, ata kishin qëndruar jashtë auditorit të kinemasë, ku po zhvillohej incidenti, dhe, në një masë të madhe, nuk ndërhyrën për të çpërshkallëzuar situatën, pavarësisht se u nxitën nga organizatorët që të vepronin në këtë mënyrë. Kur ata ndërhyrën, nuk e bënë ndërhyrjen në mënyrë efektive dhe nuk e parandaluan bullizimin dhe ofendimin e kërkuesve individë nga personat që u futën brenda. Gjykata vërejt se vendimi i autoriteteve për të mos reaguar pavarësisht se ishin në dijeni të përmbajtjes së sharjeve të bëra dukej se tregonte paragjykim ndaj homoseksualëve, i cili vijoi edhe me raportimin e tyre të mëvonshëm për incidentin në kinema: raportet e policisë e përshkruan incidentin në terma që injoronin plotësisht homofobinë. Ndaj, autoritetet nuk kishin arritur ta realizonin detyrën e tyre për mbrojtjen e kërkuesve në gëzimin e të drejtave të tyre pa diskriminim.

Sa i përket detyrimit për hetim, Gjykata vërejt se pavarësisht se policia ishte e pranishme dhe se ishte bërë ankesa brenda dy javësh nga incidenti, prokurorisë iu desh një vit që të fillonte hetimin efektiv dhe tre vjet e gjysmë të tjera para se ai të mbyllej. Gjykata u shpreh se koha e kaluar është e mjaftueshme jo vetëm për minimin e hetimit, por edhe për komprometimin përfundimtar të shanseve të tij për të përfunduar ndonjëherë. Teksa hetimi duhet të kishte qenë i lehtë, Gjykata

vërejt se asnjë nga personat që u futën në muze nuk u akuzua kurrë zyrtarisht nga prokurori. Autoritetet lokale kishin arritur në përfundimin se fjalët “vdekje për homoseksualët” nuk përbënin gjuhë urrejtjeje dhe nuk kishin marrë aspak parasysh natyrën homofobike të kërcënimeve dhe fyerjeve. Abuzimi verbal që pësuan kërkuesit u referua thjesht si “diskutim” ose “shkëmbim pikëpamjesh”. Po ashtu, autoritetet vendase nuk kishin marrë parasysh se organizata, e cila dukej se qëndronte pas sulmeve, kundërshtonte fort marrëdhëniet homoseksuale. Mosmarrja e hapave të arsyeshëm përbënte shkelje të detyrimit të autoriteteve për hetimin e sulmeve homofobike.

Duke marrë parasysh të drejtën për lirinë e tubimit, Gjykata theksoi se në bazë të kësaj të drejte, shtetet duhet t’u garantojnë protestuesve mbajtjen e demonstratave apo tubimeve pa pasur frikë se do t’i nënshtrohen dhunës – edhe nëse tubimi mund të fyejë ose ofendojë personat që kundërshtojnë idetë ose pretendimet që promovon ai demonstrim. Këtu përfshihen takimet private dhe publike. Liria e vërtetë dhe efektive e tubimit paqësor nuk mund të reduktohet në një detyrim të thjeshtë nga ana e shtetit për të mos ndërhyrë. Duke zbatuar parimet në fjalë të çështje dhe duke përshkruar të njëjtat mosarritje të policisë të identifikuara sipas arsyetimit të Nenit 8/Nenit 14 të përmbledhur më sipër, Gjykata vendosi se dështimi i qartë i autoriteteve për të mbrojtur kërkuesit shkelte të drejtën e tyre për lirinë e tubimit. Fakti që shoqata e anuloi vetë shfaqjen dhe vendosi ta zhvillonte atë në një datë të mëvonshme, nuk e ndryshoi përfundimin e Gjykatës. Autoritetet kishin detyrimin të përdornin çdo mjet të mundshëm për të garantuar respektimin e të drejtës së kërkuesve për tubim paqësor.

### Komente të përgjithshme

Çështja ngre dy probleme të rëndësishme: (1) detyrimin e shtetit për të ndërmarrë veprime kundër gjuhës së urrejtjes dhe (2) detyrimin e shtetit për të ndërmarrë hapa për të ushtrimin e së drejtës së lirisë së tubimit pa protesta të dhunshme.



Për sa i përket problemit të dytë, detyrimi i shtetit për të ndërmarrë hapa për të mundësuar gëzimin efektiv të të drejtave është tashmë i mirëpërcaktuar (shih, ndër të tjera, aktgjykimin e Gjykatës në çështjen [Identoba dhe të tjerë kundër Gjeorgjisë](#), aktgjykim i datës 12 maj 2015, kërkesa nr. 73235/12).

Për sa i përket problemit të parë, Gjykata e ka bërë gjithnjë e më të qartë se Neni 8 kërkon që shtetet të veprojnë në mënyrë të vendosur dhe efektive për mbrojtjen e individëve ose të grupeve kundër gjuhës së urrejtjes: “Çdo stereotipizim negativ i një grupi, kur arrin një nivel të caktuar, mund të ndikojë mbi ndjenjën e identitetit të grupit dhe ndjenjat e vetëvlerësimit dhe vetëbesimit të anëtarëve të grupit. Në këtë kuptim, ai mund të shihet që ndikon në jetën private të anëtarëve të grupit ... Aktet e dhunës si ... bërja e kërcënimeve verbale mund të kërkojnë që shtetet të miratojnë masat e duhura pozitive në sferën e mbrojtjes së të drejtës penale. Standardi gjithnjë e më i lartë që kërkohet në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore kërkon, përkatësisht dhe në mënyrë të pashmangshme, një vendosmëri më të madhe në vlerësimin e shkeljeve të vlerave themelore të shoqërive demokratike” ([R.B kundër Hungarisë](#), aktgjykimin i datës 12 prill 2016, kërkesa nr. 64602/12, paragrafi 78, 83). Kjo vlen për gjuhën e urrejtjes së motivuar nga homofobia, si dhe gjuhën e urrejtjes raciste, nacionaliste, fetare, etnike dhe mizogjene. Në çështjen e [Beizaras dhe Levickas kundër Lituanisë](#) (kërkesa nr. 41288/15, aktgjykimin i datës 14 janar 2020), Gjykata u shpreh se për shkak të lehtësisë me të cilën postimet në internet mund të bëhen virale, “madje edhe postimi i një komenti të vetëm urrejtjeje [është] mjaftueshëm për t’u marrë seriozisht”. Duke pasur parasysh përhapjen e urrejtjes në internet, mund të pritet që më shumë çështje të vijnë në Gjykatë, të sjella ose nga individë të dënuar për gjuhën e urrejtjes ose nga njerëz të shënjestruar prej saj, duke i mundësuar kështu Gjykatës të rregullojë jurisprudencën e saj dhe duke i udhëzuar shteteve si të përdorin të drejtën penale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Një çështje e tillë, siç tregohet në hyrje të këtij buletini, ndodhet aktualisht përpara Dhomës së Madhe: aktgjykimin për [Sanchez kundër Francës](#) do

të vendosë një standard të rëndësishëm sa i përket detyrimit të politikanëve për heqjen e gjuhës së urrejtjes nga faqet e tyre në Facebook.

## [Dareskizb kundër Armenisë, aktgjykimin i datës 21 shtator 2021, kërkesa nr. 61737/08](#)

### Faktet e çështjes

**K**ërkuesi është botues i një gazete të përditshme, “Haykakan Zhamanak” (Kohët Armene), e cila dihej se anonte politikisht nga opozita e atëhershme politike. Kërkesa e tij ka të bëjë me ndalimin e një publikimi të njoftuar në kuadër të gjendjes së jashtëzakonshme.

Në vitin 2008, përpara shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve presidenciale, kandidati i opozitës u bëri thirrje mbështetësve të mblidheshin në qendër të kryeqytetit të Armenisë, Jerevan. Mijëra mbështetës u përgjigjën dhe ngritën një kamp të përkohshëm. Pas nëntë ditësh proteste, sheshi ku ndodhej kampi u spastrua dhe u mbyll. Më pas, protesta u zhvendos në një zonë tjetër, ku ndodhën përlëshje të dhunshme me oficerët e zbatimit të ligjit që çuan në dhjetë të vdekur dhe disa të plagosur. Për një periudhë 20-ditore u shpall gjendja e jashtëzakonshme, e cila përfshinte kufizime të vendosura për mediat. Armenia i paraqiti një shënim Këshillit të Evropës ku thuhej se, përgjatë kohëzgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme do të derogonte ose kufizonte zbatimin e një sërë të drejtash të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë të drejtën për lirinë e shprehjes. Një natë, gazeta e kërkuesit u ndalua të shtypej nga oficerët e sigurimit kombëtar pa dhënë arsyetim. Kërkuesi nuk u përpoq ta shtypte gazetën e tij edhe për nëntë ditë të tjera, kur Presidenti i Armenisë ndryshoi dekretin e tij fillestar, duke çuar në “ndalim të publikimit ose shpërndarjes nga organet e masmedias të informacionit dukshëm të rremë ose destabilizues për çështjet shtetërore dhe të brendshme, ose të thirrjeve për të marrë pjesë në aktivitete të paligjshme (ilegale), si dhe publikimin dhe përhapjen e këtyre informacioneve dhe thirrjeve me çdo mjet

dhe formë tjetër". U tentua të ri-botohej tirazhi i gazetës, po kjo gjë që u pengua nga oficerët e sigurimit kombëtar. Një javë më vonë, pas heqjes së gjendjes së jashtëzakonshme, rifilloi botimi i gazetës.

Kërkuesi u ankua në gjykatat kombëtare për veprimet e oficerëve të sigurisë kombëtare, kërkoi që dispozitat mundësuese, dhe në veçanti dekreti i presidentit, të shpallen jokushtetues, si dhe kërkoi dëmshpërblim. Gjykata Administrative refuzoi ta dëgjonte çështjen me pretendimin se ajo nuk kishte juridiksion dhe apelimi dështoi për të njëjtën arsye. Gjykata Kushtetuese refuzoi të dëgjonte çështjen me pretendimin se kërkuesi nuk ishte i legjitimuar t'i drejtohej. Më pas, kërkuesi u ankua pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

### Arsyetimi i gjykatës

**S**ë pari, Gjykata shqyrtoi deklaratën e Armenisë sipas së cilës shprehej se përgjatë kohëzgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme do të shmangte ose kufizonte zbatimin e të drejtës për lirinë e shprehjes. Sipas Nenit 15 të Konventës, shtetet kanë të drejtë që në kohë lufte ose në gjendje të jashtëzakonshme publike që kërcënon jetën e kombit, të marrin masa që shmangin detyrimet e tyre sipas Konventës, me kusht që këto masa të jenë rreptësisht në proporcion me kërkesat për situatën dhe të mos bien ndesh me detyrimet e tjera sipas të drejtës ndërkombëtare. Shtetet nuk kanë diskrecion të pakufizuar në këtë çështje: Gjykata mund të vendosë nëse shtetet kanë shkuar përtej masave të kërkuara rreptësisht nga nevojat e krizës. Gjykata theksoi se kuptimi natyror dhe zakonor i fjalëve "gjendje të tjera të jashtëzakonshme publike që kërcënojnë jetën e kombit" i referohen "një situatë të jashtëzakonshme krize ose emergjence që prek të gjithë popullsinë dhe përbën kërcënim për jetën e organizuar të komunitetit nga i cili përbëhet shteti". Për të justifikuar shmangien, gjendja e jashtëzakonshme duhet të jetë aktuale ose e afërt; duhet të prekë mbarë kombin në masën që të kërcënohet vazhdimësia e jetës së

organizuar të komunitetit; dhe kriza ose rreziku duhet të jetë i jashtëzakonshëm aq sa masat ose kufizimet normale, të lejuara nga Konventa për ruajtjen e sigurisë, shëndetit dhe rendit publik, janë qartësisht të papërshtatshme.

Me zbatimin e këtyre kritereve për situatën, Gjykata vërejti se ngjarjet në fjalë ishin kulmi i dhjetë ditëve protestë paqësore pas zgjedhjeve presidenciale që shumë besonin se ishin të meta. Nuk kishte asnjë indikacion për dhunë, dhe as që demonstruesit të ishin të parët që e sulmuan policinë; përkundrazi, raportet e besueshme treguan se policia përdori forcë të pajustifikuar dhe të tepruar kundër demonstruesve (diskutuar nga Gjykata në çështjen *Mushegh Saghatelyan kundër Armenisë*, aktgjykim i datës 20 shtator 2018, kërkesa nr. 23086/08). Teksa Gjykata pranoi se tensionet po rriteshin, nuk pati asnjë provë për destabilizim të planifikuar dhe të organizuar ose të një tentativë për grusht shteti. Turmat ishin kryesisht paqësore dhe dhuna u shkaktua nga grupe të vogla protestuesish duke përdorur objekte të improvizuara në krahasim me armët e zjarrit ose armë të ngjashme. Nuk pati asnjë provë se ndonjëra nga vdekjet kishte ndodhur si rezultat i veprimeve të protestuesve. Gjykata doli në përfundimin se nuk pati asnjë provë që demonstratat e opozitës të mund të karakterizoheshin si gjendje e jashtëzakonshme publike "kërcënuese për jetën e kombit", dhe as që ato përfaqësonin një situatë që të justifikonte derogimin. Rrjedhimisht, gjykata vendosi se derogimi ishte i pavlefshëm.

Për t'iu kthyer ndalimit të botimit të gazetës, Gjykata theksoi se publikimi i gazetës ishte ndaluar pavarësisht përmbajtjes e saj, duke mos përfshirë gjuhën e urrejtjes ose nxitjen për trazira; dukej se kufizimet ishin zbatuar vetëm sepse gazeta kishte qenë kritike ndaj autoriteteve. Kufizimet ishin në kundërshtim me vetë objektin e Nenit 10 të Konventës dhe nuk kishin qenë të nevojshme në një shoqëri demokratike. Gjykata u shpreh më tej se refuzimi i gjykatave vendase për të dëgjuar ankesën e kërkuesit cenonte vetë thelbin e së drejtës së aksesit në gjykatë të shoqërisë kërkuese, në kundërshtim me Nenin 6 të Konventës.

**K**y është një vendim i rëndësishëm (është regjistruar si “çështje kyçe” në bazën e të dhënave online të Gjykatës) që tregon se shtetet nuk duhet ta vendosin lehtësisht gjendjen e jashtëzakonshme: shteti i së drejtës zbatohet edhe kur në një vend ka çrregullime ose dhunë. Siç tregohet edhe në aktgjykim, Gjykata tashmë ka shqyrtuar çështje të tjera që rrjedhin nga e njëjta periudhë, duke gjetur shkelje të të drejtave për liri, lirisë së shprehjes dhe lirisë së organizimit në rastet kur protestat ishin shpërndarë dhe protestuesit ishin arrestuar (përveç *Mushegh Saghatelyan kundër Armenisë*, shih për shembull edhe *Myasnik Malkhasyan kundër Armenisë*, aktgjykimi i datës 15 tetor 2020, kërkesa nr. 49020/08). Kjo ishte çështja e parë që shqyrtoi në mënyrë eksplite derogimin nga Armenia në bazë të Nenit 15, sipas të cilit ishte dekretuar që masmedia mund të publikonte vetëm lajme zyrtare të qeverisë dhe disa mediave të pavarura u ishte penguar plotësisht publikimi (përveç kërkuarit, media si A1+ dhe Radio Free Europe/Radio Liberty ishin penguar gjithashtu të publikonin, si dhe faqet e internetit të disa mediave të tjera ishin bllokuar). Aktgjykimi vendos standardin e rëndësishëm për Nenin 15, duke e bërë të qartë se të drejtat mund të derogohen vetëm kur ka gjendje të jashtëzakonshme që kërcënon vërtet “jetën e kombit”.

Ashtu si vendimi i Nenit 15, diskutimi i Gjykatës për Nenin 10 është po aq i rëndësishëm: edhe gjatë një emergjence, Gjykata thekson se, “Shtetet kontraktuese duhet të kenë parasysh se çdo

masë e marrë duhet të synojë mbrojtjen e rendit demokratik nga kërcënimet dhe duhet të merren të gjitha masat për mbrojtjen e vlerave të një shoqërie demokratike si pluralizmi, toleranca dhe mendje-gjerësia.” Në fund të fundit, “një nga karakteristikat kryesore të demokracisë është mundësia që ajo ofron për të zgjidhur problemet përmes debatit publik... Demokracia lulëzon në lirinë e shprehjes”.

Derogimet janë të rralla dhe para vitit 2020 ishin aplikuar vetëm nga pesë shtete. Më pas erdhi COVID-19. [Një sërë shtetesh shpallën gjendje të jashtëzakonshme dhe deroguan nga disa të drejta të Konventës](#), duke përfshirë të drejtën për lirinë e shprehjes. Në mars 2020, Armenia njoftoi Këshillin e Evropës se dëshironte të derogonte nga detyrimet e saj sipas Konventës; ndër të tjerë, ajo kishte nxjerrë një dekret që kërkonte që mediat të publikonin vetëm “informacione zyrtare” dhe të mos e kundërshtonin atë (Vendimi i Qeverisë së Republikës së Armenisë Nr. 298-N i datës 16 mars 2020). Derogimi u tërhoq vetëm në shtator 2020 ([Note verbale](#), 16 shtator 2020). Vetëm një numër shumë i vogël shtetesh ndërmorën derogime të ngjashme kufizuese ([COVID dhe Fjala e lirë](#), Dokument i Përkohshëm, Konferenca Ministrore, Qipro 2020); të gjithë u kritikuan jo vetëm për natyrën e ashpër të shtypjes së tyre, por për ndjekjen e një politike që pengonte në mënyrë aktive zgjidhjen e pandemisë COVID-19. Liria e shprehjes nuk është vetëm burimi jetësor i demokracisë, por lejon edhe diskutime dhe debate shkencore që çojnë përfundimisht në gjë-tjen e zgjidhjeve.

## Liria e shprehjes dhe liria e mediave në Evropën Juglindore (JUFREX)

Projekti është i pjesë e "Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019–2022" dhe bazohet në rezultatet e arritura gjatë programit të mëparshëm të bashkuar rajonal të BE/KE "Përforsimi i Ekspertizës Gjyqësore mbi Lirinë e Shprehjes dhe Medias në Evropën Juglindore (JUFREX)". Veprimi rajonal është i ndërlidhur fuqishëm me gjashtë veprimet JUFREX që janë specifike për Përfituesin në: Shqipëri, Bosnjë e Hercegovinë, Kosovë\*, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbi.

Aktivitetet e JUFREX implementohen me synim që të:

- "Promovojnë lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias në përputhje me standardet evropiane;
- "Përmirësojnë zbatimin e atyre standardeve duke angazhuar një sërë aktorësh përgjegjës për të aplikuar standarde të tilla në punën e tyre të përditshme, përkatësisht: gjyqtarë, prokurorë, avokatë, oficerë policie, përfaqësues të autoriteteve rregullatore të mediave, aktorë të medias dhe studentë;
- "Konsolidojnë një platformë për bashkëpunim, diskutim dhe shkëmbim rajonal të praktikave të mira.

Kur ekziston një mjedis favorizues për lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias dhe e drejta për të kërkuar, dhënë dhe marrë informacion është e mbrojtur mirë, qytetarët mund të marrin pjesë vërtet në proceset demokratike. Institucionet kombëtare të trajnimit për profesionistët ligjorë (Akademitë Gjyqësore dhe Dhoma e Avokatëve) luajnë rol kryesor për ta bërë këtë realitet.

Të gjitha aktivitetet e JUFREX bazohen në mjete inovative dhe moderne të mësimnxënies për lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias dhe përvetësojnë një metodologji dinamike për mësimnxënie nga të rriturit dhe një model kokë-më-kokë.

"Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019–2022" është një iniciativë e bashkuar e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës që u mundëson Përfituesve t'i përmbushin agjendat e tyre të reformave në fushat e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe demokracisë dhe të jenë në përputhje me standardet evropiane, përfshirë aty ku është e nevojshme brenda kornizës së procesit të zgjerimit të BE-së.

Ky dokument është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.

\* Ky përkufizim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e të drejtave të njeriut në kontinent. Ai përfshinë 46 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i krijuar për t'i mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

[www.coe.int](http://www.coe.int)

Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian vendosën që gradualisht ta lidhin dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku ata ndërtuan një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke ruajtur larminë kulturore, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian i zotohet bashkëndarjes së arritjeve dhe vlerave të tij me shtetet dhe popujt përtej kufijve të tij.

[www.europa.eu](http://www.europa.eu)

Financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet nga Këshilli i Evropës